

Aktivitet i mbajtur nga Organizata Special Olympics Albania në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit.

Sot në datë 14.12.2022 në ambjentet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, u zhvillua workshopi teorik dhe praktik me temë: “Sporti gjithëpërfshirës”, organizuar nga Special Olympics Albania në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës, Alumnit.

Workshopi i sotshëm u zhvillua në kuadër të projektit “Ne jemi kampionë”, orientuar rreth sportit gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuar intelektuale.

Target grupi i studentëve të përzgjedhur në këtë trajnim ishte nga programet e studimit: Fizioterapi dhe Logopedi.

Fjalën e hapjes e mbajti Roland Hysi drejtor i Special Olympics Albania, i cili pasi bëri një prezantim të shkurtër rreth kësaj organizate ftoi studentët e pranishëm në sallë të bëhen pjesë e grupit të vullnetarëve që operojnë pranë kësaj OJF-je.

Pjesë e panelit znj. Fatma Spahiu, drejtor i Drejtorisë Juridike, Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit në UE përshëndeti dhe ftoi studentët të aktivizohen sa më tepër në vullnetarizëm pasi për ata do të shërbente si një eksperiencë pune tepër e vlefshme. Gjithashtu zonja Fatma bëri një prezantim të shkurtër të Sektorit të Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit dhe mbështetjes që ky sektor u ofron studentëve gjatë gjithë periudhës studentore.

Qëllimi i këtij workshopi ishte të angazhonte sa më shumë të rinj vullnetarë në këtë projekt, angazhim i cili do t’u vlente studentëve edhe si praktikë pune pranë UST, por njëkohësisht edhe si eksperiencë mbi sportin e unifikuar.

Trajnimi ishte i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë ishte ajo teorike, ku studentët u njohën me projektin dhe pjesa e dytë ishte ajo praktike, e cila do të kryhej fizikisht pranë shkollës speciale “Zëra Jete”.

Në fund të trajnimit, kjo eksperiencë u finalizua me dhënien e një certificate të njohur ndërkombëtarisht.



